

Tirane me 03.02.2016

**DREJTUAR: AKM-TIRANE
PER DIJENI: DRM-LEZHE
BASHKIA LEZHE, QARKU LEZHES**

**LENDA: KERKESE PER PJESEMARRJE NE
ORGANIZIMIN E KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE
PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE
MJEDISI TE TIPIT B: INDUSTRIE ENERGETIKE,
FURNIZIMI PER MBUSHJE GAZI GLN, ID 1.11
KAPACITETI MBI 10M³**

SUBJEKTI : SUBJEKTI “KEVIN-GAZ” SH.A.

ADMINISTRATORI: Z. GJERGJ LEKAJ

**ADRESA : OBJEKTI GJENDET NE AKSIN RRUGOR
LEZHE-SHKODER (200 M/L NE TE MAJTE)
NE AFERSI TE FSHATIT ISHULL-LEZHE,
NJESIA ADMINISTRATIVE SHENGJIN,
BASHKIA LEZHE, QARKU LEZHE**

LEZHE 2016

Subjekti “KEVIN-GAZ” SH.A. me perfaqesues ligjor Z.GJERGJ LEKAJ merret me Aktivitetin INDUSTRIE ENERGJITIKE, FURNIZIMI PER MBUSHJE GAZI GLN, ID 1.11 KAPACITETI MBI 10M3.

SUBJEKTI : SUBJEKTI “KEVIN-GAZ” SH.A. ME NR. NIPTI K68411501W

ADMINISTRATORI: Z. GJERGJ LEKAJ

**ADRESA : OBJEKTI GJENDET NE AKSIN RRUGOR LEZHE-SHKODER
(200 M/L NE TE MAJTE) NE AFERSI TE FSHATIT ISHULL-LEZHE,
NJESIA ADMINISTRATIVE SHENGJIN, BASHKIA LEZHE, QARKU
LEZHE**

Subjekti ka disa vite qe ushtron aktivitetin ne kete Depozita per Gaz GLN. Ne afersi te zones ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkolla ,vepra arti,argjinatura,linje eletrike dhe linje uji qe mund te demtohen nga zhvillimi i aktivitetit.

Pervec interesit ekonomik , investitori ka bere rregullime ,sistemime te sheshit para objektit, rrugeve, ka krijuar hapsira te gjelberta.

Duhet theksuar qe subjekti ka disa vite qe e ushtron kete aktivitet ne keto ambiente i pajisur me Leje Mjediosore, Licensa, Vertetim Teknik nga ISHTI, relacion teknik i mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin, Akt-Miratimi Projekti Teknologjik, dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipermarresit qe kane aktivitetet prane Aktivitetit, per me teper qe nuk ka asnje banese ne afersi.

Teritori i zgjedhur eshte mjaft i pershtatshem per funksionimin e ketij aktiviteti duke paraqitur disa perparesi si:

- Sistem perspektiv te furnizimit me energji elektrike.
- Mundesi per zbatimin korekt te projektit
- Mundesi per ngritje te sistemit te kanalizimeve dhe shkarkimeve.

Pozicioni i Depozita per Gaz GLN ka te zgjidhura disa nga problemet qe lidhen me anen funksionale si.

- Largesi te mjaftushme nga vendet e banuara.
- Prane fuqise punetore.

Objekti ndodhet ne distanca te largeta nga qendrat e banuara, si dhe aktiviteti ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

- **Sipërfaqja e objektit është 1.02 ha.**
- **Kapaciteti Depozitues sipas ISHTI 510 m³ .**

Gazi i lenget eshte nje perzierje hidrokarburesh ku me kryesoret jane propani dhe butani, keto dy gaze kthehen ne gjendje te lenget pasi jane vene ne presione jo shume te larta dhe temperature te ulet. Te kthyer ne gjendje te lenget keto gaze jane lehtesisht te transportueshme, duke perdorur pajisje nen presion (autocisternat). **GLN ka fuqi te larte kalorifike, nuk ben tym, nuk le mbetje, nga djegia e tij nuk clirohen mbetje qe ndotin mjedisin pra eshte miqesore me ambientin.**

Projekti i propozuar i pajisur me Leje Mjedisore ka si qellim pike te tregetimit te gazit natyror te lenget (GNL) me qellim magazinimit e gazit dhe me pas mbushjen e bomblave si dhe infrastruktures mbeshtetese te tij si magazina, plateforme sherbimi, zyra etj.

Magazinimi dhe ruajtja e produktit behet ne rezervuare metalike me kapacitet te pergjithshem 510m³, te vendosur horizontalisht mbi jasteke betoni mbi siperfaqen e tokes ndersa tregetimi do te behet nepermjet rregullave teknike te sigurise.

Ne kuader te rritjes se vazhdueshme te rritjes se kerkeses per energji dhe lende djegse sherbimi i ofruar nga ky projekt paraqitet teper i nevojshem dhe u vjen ne ndihme jo vetem familjareve te qytetit te Lezhes dhe Shkodres por edhe bizneseve dhe komunave pereth qytetit.

Trualli ku deshte instaluar dhe ushtrohet veprimtaria e pikes te tregetimit te gazit natyror te lenget (GNL) me qellim magazinimit e gazit dhe me pas mbushjen e bomblave si dhe infrastruktures mbeshtetese te tij si magazina, plateforme sherbimi, zyra etj eshte prone e Shoqerise Kevin-Gaz Sh.a .

Trualli gjendet ne zone industriale te Komunes Shengjin ne fshatin Ishull Lezhe dhe ne afersi te tij nuk gjenden banesa dhe objekte te rendesishme sepse kjo eshte zone teresisht industriale.

Ne siperfaqen prej 1.02ha te truallit eshte bere ndertimi i disa ambjenteve te qe do te sherbejne per ushtimin e aktivitetit te tregetimit te GNL-se.

Hapesira ku realizohen operacionet e aktivitetit pershkrohet nga nje sere kanalesh siperfaqesore dhe pusetash qe lidhen me separatorin dhe me pas me kolektoret e kanalizimeve te zones. Koeficienti i perdorimit te hapesires tokesore eshte i vogel rreth 29% dhe do te ze nje siperfaqe ndertimi prej 920m2 duke siguruar keshtu hapesire te mjaftueshme per sigurine e kompleksit.

Baza ligjore ku mbeshtetet plani I emergjencave

1. - Ligji Nr. 8934, date 05.09.2002 “Per mbrojtjen e mjedisit”
2. - Ligji Nr. 9108, date 17.07.2003 “ Per substancat dhe preparatet kimike”
9. - Ligji Nr. 8756, datë 26.3.2001 “PËR EMERGJENCAT CIVILE”

Projekti zbatohet gjithashtu edhe ne perputhje me ligjet dhe aktet nenligjore per urbanistiken dhe organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

Emergjencë civile, kuptohet një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin.

Shoqëria **Kevin-Gaz Sh.a** . me aktivitetin e saj do të përballojë çdo lloj emergjence civile duke synuar:

- a) parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim që prek popullatën, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin nga emergjencat civile;
- b) sigurimin e kushteve për institucionet shtetërore, publike e private, për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën, për kalimin nga gjendja normale e jetesës dhe e punës në një situatë emergjente, me humbje sa më të vogla për ruajtjen e rendit, për jetën e njerëzve, për gjënë e gjallë, për pronën, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin kundër efekteve të një emergjence civile;
- c) garantimin e përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme të shtetit, me qëllim sigurimin publik, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë kombëtare, lokalizimin e zonës së emergjencës dhe lehtësimin e pasojave.

Sistemi i mbrojtjes nga zjarri.

- Ky është një aspekt të cilit i është kushtuar vëmendje e veçantë nga investitori dhe projektueset sepse përveç rreziqeve dhe humbjeve të vlerave ekonomike për shoqërinë ai është tepër i rëndësishëm edhe për sigurinë sociale dhe mjedisore. Në vijë të përgjithshme sistemi i mbrojtjes nga zjarri do të përbehet nga një

rezervuar uji per MNZ me volum prej 100 m³. Ne hapesiren e stacionit per qellime te mbrojtjes nga zjarri jane vendosur nje sere tubash celiku dhe saracineskash (sheshi i mbushjes se bomblave, magazinën e ruajtjes se bomblave) Sistemi i tubacionit te ujit per mbrojtjen nga zjarri lidhet me rezervuarin dhe rrjetin e furnizimit me uje dhe do te mbeshtetet nga nje pompe e cila do te garantoje presion te mjaftueshem per hedhjen e ujit ne sasi dhe distance. Gjithashtu mbi gjithe siperfaqen e cisternave te GNL eshte i montuar tubacion metali i cili do jete ne gjendje qe te mbuloje me uje tere siperfaqen e cisternave dhe do te leshoje uji mi to ne forme shiu. Kjo praktike zbatohet dendur gjate stines se veres per te ulur temperaturat dhe fikur ndonje zjarr te mundshem. Ne rast te ndonje zjarri te mundshem ne stacion jane ne gjendje dy zorra te shkarrkimit te ujit me D 45 si dhe 1 fikse 50 kg me shkume, 2 fiksa 50 kg universal me puder, 5 fikse 6 kg universal me puder, 1 fikse 5 kg me gaz karbonik CO₂ te vendosura ne platformen e mbushjes se bomblave.

Gjithashtu ne objekt pervec rrjetit te hidratanteve, dhe mjeteve zjarrefikse me pluhur dhe shkume, stacionare ose me rrota ne funksion te Rregullores perkatese, si dhe do te afishohet Rregulloret e MNZ.

Gazi i lengezuar i naftes nuk perben impakt negativ ambientin. Megjithate per vete kushtet e punes si leng nen presion, aparaturat dhe pajisjet jane te tilla qe nuk lejojne absolutish asnje rrjedhje. Pervec kesaj ne rezervuar jane vendosur valvola fluksi dhe kundravolva ne te gjitha konjeksionet e tij, me qellim bllokimin e menjehershem te rezervuarit per cdo rast te konstatimit te rrjedhjeve ne tubacione dhe pajisje.

Konsiderohen si pika te mundshme te lindjes se zjarrit, vendvendosjet e distributoreve, pompave dhe pistoletave te furnizimit si dhe sidomos vendi i shkarkimit te autocisternave qe mbushin rezervuaret. Rrezik zjarri paraqesin edhe valvolat e shkarkimit te avujve dhe gazeve nga rezervuaret.

Duke u nisur nga me siper jane marre keto masa parandaluese:

- a. Vezhgimi i vazhdueshem i sistema te tubacioneve, rezervuarve dhe distributoreve
- b. Jane instaluar saracineska uji ne te gjithë territorin e kompleksit dhe eshte ne gjendje perdorimi tub plastik cilesore qe mbulon te gjithë perimetrin e hapësirës
- c. Jane vendosur rrjeti i elektrodave te tokezimit dhe jane tokezuar te gjitha pajisjet gjithashtu jane vendosur edhe rrufe – pritesa bakri 1.5mm mbi objekt, tentoje dhe ne platformen e rezervurve

Ambjentet e kompleksit jane plotesisht te ndricuara dhe te pajisura me sinjalizime fosoreshente per te evituar cdo aksident te mundshem. Per te zbutur sa me maksimalisht keto ndikime shoqeria Kevin-Gaz Sh.a eshte konsultuar dhe ka investuar ne nje teknologji me pajtuesmeri optimale mjedisore e cila pranon modifikme dhe permirsime te saj ne rast te teknologjive te reja me efikase.

Shoqeria angazhohet te kontrolloje, monitoroje dhe beje perpjekje te vazhdueshme per te instaluar teknologji te re qe minimizon ne maksimum efektet negative te veprimtarise se saj.

Gjithashtu kompania eshte e hapur ti nenshtrohet cdo lloj auditimi dhe monitorimi nga institucione te administrimit dhe mbrojtjes se mjedisit perfshi dhe NGO si dhe trupa shkencore.

Aktiviteti zhvillohet ka kohë që ekziston dhe nuk ka patur asnje problem me komunitetin dhe nuk ka shkaktuar probleme të ndotjes së mjedisit.

Me këtë raport sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Aktiviteti jone ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Ne Depozita per Gaz GLN jane punesuar 8 punonjes te perhershem.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i ketij aktiviteti eshte faktor per zbutjen e papunesise dhe burim te ardhurash per familjet qe jetojne duke punuar ne kete shoqeri.

Arsyet për përzgjedhjen e këtij vendi për të kryer aktivitetin Z. GJERGJ LEKAJ janë:

- Aktiviteti ndodhet në një vend startegjik për zhvillimin e aktivitetit.
- Aktiviteti ndodhet në një zonë qe nuk dëmton Komunitetin.

Ndikimet në mjedis

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbëtjeve të rrezikshme
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikoj në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonën ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.

- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Niveli i zhurmës nuk i kalon 55-70 dB(A) gjatë punës. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.
- Trafiku rrugor. Gjatë këtij aktiviteti nuk do të ketë ndikime në aktivitetin rrugor.
- Projektet e tjera si: rrugët e reja, kanalet e ujrave të zeza, banesat, linja të energjisë, naftë dhe gazsjellës, linja të telekomunikacionit etj. nuk do të ndikohen nga aktiviteti i subjektit KEVIN-GAZ.

Masat mbrojtëse për punonjësit

Punëtorët janë të pajisur me librezat shëndetësore përkatëse.

Mbrojtja në punë dhe ruajtja e shëndetit të punonjësve që punojnë në magazinën e perpunimit të ullirit realizohet duke zbatuar:

- Rregulloren e sigurimit teknik
- Normativat e ndotësve në mjediset e punës të miratuara nga Inspektorati i Higjenës së Punës

Subjekti “KEVIN-GAZ” SH.A. ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare për të zhvilluar këtë aktivitet dhe kërkon të jetë e pajisur me të gjitha lejet përkatëse sipas legjislacionit shqipëtar.

KONKLUSIONE

Subjekti "KEVIN-GAZ" SH.A. do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresë çdo sygjërim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti ka bërë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone.

Aktiviteti jone në përputhje me VKM nr. 419 datë 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKL-ja, ky subjekt duhet të aplikojë për leje mjedisi të tipit B në AKM-Tirane.

Adresa e AKM-se, ku publiku mund të dergojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë Elektronike:

Adresa: Rruga "Sami Frasheri" Nr.4, Tirane, - Tel/Fax 04 2 371 237 www.akm.gov.al

KONFORM TE TE GJITHA AKTEVE DHE PROCEDURAVE LIGJORE NE FUQI I DREJTOHEM AKM-TIRANE PER NDJEKJEN E PROCEDURES KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B:

INDUSTRITE ENERJGJITIKE, FURNIZIMI PER MBUSHJE GAZI GLN, ID 1.11
KAPACITETI MBI 10M3

ADMINISTRATORI
GJERGJ LEKAJ

TEL: 0672082422

TEL: 0695141396